

## Si në Kosovë, si në Zvicër (botuar në "Zëri", më 15 mars 2012)

Titulli i mësipërm qëllimisht ka kuptim të dyfishtë, atë që artistët shpesh e quajnë double entendre. E ka kuptimin e ëndrrës, fatkeqësisht të këputur, të shumicës së popullit tonë për ndërtimin e një shteti modern dhe të zhvilluar ekonomikisht, si Zvicra. Por, edhe kuptimin e dëshpërimit, prapë të shumicës, me kulmin e marrëzive dhe mungesës së integritetit të një numri anëtarësh të dalluar të shoqërisë sonë të treguar jo vetëm në Kosovë, por edhe në Zvicër.

Disa mendojnë se kur shkruhet seriozisht, nuk duhet të preokupohemi me një shembull specifik. Por, ata që e pohojnë këtë e nënvlerësojnë rëndësinë jo vetëm ilustrative të shembujve, sidomos atyre sinjifikativë, por edhe të mundësisë së dekurajimit të përsëritjes të së keqes, nëse ne e kundërshtojmë atë në raste konkrete. Nuk mjafton të thuhet "jemi kundër korrupsionit". Kundërshtimi ka kuptim vetëm kur të dëshmohet me vepra konkrete, në raste konkrete.

Rasti i kohëve të fundit i një deputeti të Kuvendit të Kosovës dhe ish-udhëheqës i UÇK-së, i cili haptazi akuzohet nga institucione zvicerane për mashtrim dhe keqpërdorim të sistemit të tyre përkrahës për invalidë ose për raste sociale, duhet diskutuar haptas, pa marrë parasysh se për kë bëhet fjalë. Natyrisht, ky diskutim nuk guxon të nxjerrë konkludimin për fajësi para se ajo të vërtetohet, por gjithsesi nxjerr disa konkludime të tjera, në formë të leksioneve dhe udhëzimit për hapa të nevojshëm për Kuvendin, partitë politike dhe institucionet e tjera në Kosovë.

Së pari, elementi UÇK. Nuk do mend se kurdo që përmendet në kontekst jopozitiv dikush që ka qenë në krye të UÇK-së, ekziston rreziku se përmendja mund të shihet si sulm i luftës sonë për liri. Por, edhe pse kjo tendencë ekziston tek disa, më e rrezikshmja sot është tendenca e individëve të caktuar që ta barazojnë një luftë të tërë, një vizion të kamotshëm të popullit shqiptar, një sakrificë të madhe, me disa udhëheqës, sado të rëndësishëm të kenë qenë ata në luftën tonë. Asnjë individ i vetëm nuk është pronar i të drejtës së një populli për t'u organizuar për liri, e njëkohësisht askush nuk mund ta përdorë si mburojë për keqpërdorime ose krime rolin e tyre në atë organizim liridashës dhe lirisjellës. As çlirimi e as liria e një populli nuk mund të monopolizohet.

Lufta e UÇK-së ishte e lavdishme jo pse udhëheqësit e saj ishin të përkryer, por sepse ata udhëheqës dhe të gjithë të tjerët që iu bashkuan e çmuan të arsyeshme që jetën e tyre ta sakrifikojnë për jetën e lirë të popullit. Ajo ishte një sakrificë që do të respektohet përherë edhe

sepse ishte bërë në kushte tërësisht asimetrike lufte dhe se u riktheu qytetarëve dinjitetin e tyre të ndrydhur përditë, ëndrrën e thyer për liri. Por, nëse një vepër, një akt ose një sakrificë, sado madhore, mendohet të përdoret për justifikimin e cilitdo keqpërdorim, atëherë nocioni i lirisë me qëllim po dëshirohet të kufizohet vetëm në kundërshtim të dikurshëm të okupimit. Përderisa kundërshtimi i okupimit ishte hapi i parë, i guximshëm, dhe i domosdoshëm, për lirinë tonë të sotme, liria e sotme bëhet e plotë vetëm me drejtësi ndaj të gjithë atyre që janë të dyshuar për keqpërdorim ose krime më serioze. Ajo bëhet e plotë kur garantohet liria individuale (e cenuar jo vetëm nga okupimi por edhe nga presionet e brendshme) dhe kur mbrohet demokracia.

Së dyti, përmendja e një deputeti të Kuvendit të Kosovës në një kontekst keqpërdorimesh të turpshme, nëse janë të vërteta, nuk duhet t'i ngacmojë vetëm të zgjedhurit zviceranë, por edhe ata kosovarë, sido që këta të fundit të jenë zgjedhur në dhjetor 2010. Ekziston bazë e mjaftueshme ligjore në Kushtetutën e Kosovës dhe në Rregulloren e Kuvendit (përfshirë shtojcën për Kodin e mirësjelljes) që do të lejonte diskutim, kundërshtim, hetim apo sanksionim parlamentar, jo në Zvicër, por në Kosovë. E ekziston një barrë morale që deputetët e Kosovës do ta kenë përderisa nuk tentojnë ta adresojnë në mënyrë adekuate këtë çështje.

Së treti, duhet të vihen në funksion organet hetuese jo vetëm në shtetin mik të Zvicrës, që vazhdon ta ndihmojë Kosovën në shumë fusha, por edhe në vetë shtetin tonë. Në rast se deklarimi i pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) i deputetit në fjalë ka qenë jo i vërtetë, siç mund të krijohet qartazi përshtypja nga dokumentet e deputetit në uebfaqen e AKK-së, atëherë kjo duhet të sanksionohet. Ky do të ishte rast i mirë që të ndryshohet baza ligjore dhe të parashihen penalizime më të ashpra për shkelësit e deklarimit për AKK se sa ato që janë të parapara me kuadrin ligjor aktual. Edhe kjo është detyrë e Kuvendit të Kosovës, e pozitës dhe opozitës. Në këtë aspekt, duhet hetuar edhe rastet e tjera të mundshme të ngjashme të ndonjë zyrtari tjetër, në Qeveri ose jashtë saj.

Miqësia me Zvicrën nuk u krijua përmes një individi e as nuk do të rrënohet përmes një individi. Por, miqësitë e vërteta bazohen në vlera e interesa të përbashkëta, e rastet si ky i fundit i një deputeti rrezikojnë t'i dëmtojnë vlerat dhe interesat e përbashkëta demokratike, sepse nuk bëhet fjalë vetëm për një qytetar të thjeshtë, por për një deputet dhe anëtar me rëndësi në partinë më të madhe. Edhe pse marrja pothuajse përherë me imazhin e fare për-rrallë me substancën është marrje me simptoma e jo me shkaktarin e këtyre të fundit, duhet theksuar se keqpërdorimet e atyre që konsiderohen të zgjedhur nga populli ynë, të cilëve nuk u shkon në mendje akti minimal i dorëheqjes, nuk e ndihmojnë imazhin e përgjithshëm, edhe ashtu

jopozitiv të Kosovës, e andaj krijojnë vështirësi më të mëdha si për bashkatdhetarët tanë jashtë Kosovës, ashtu edhe për avancimin e përgjithshëm të marrëdhënieve tona me shtetet perëndimore.

Së fundi, diskutimi i mësipërm do të ishte jo i plotë nëse nuk përmendet edhe një element shqetësues, i cili i tejkalon përmasat e rastit të mësipërm. Nuk janë të pakta situatat kur një person, një familje ose madje një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë sonë i toleron të këqijat që anëtarët e kësaj shoqërie i shkaktojnë brenda një shoqërie tjetër. Vetëm pse diçka ndodh jashtë Kosovës ose pse nuk i ndodh një anëtar të shoqërisë sonë, nuk do të thotë se edhe keqpërdorimet dhe madje krimet duhet toleruar ose përkrahur. Niveli i demokracisë së shoqërisë sonë matet edhe me normat me të cilat kërkojmë që anëtarët tanë të sillen jashtë Kosovës si dhe në raport me ata që nuk jetojnë në trevat tona.

Sot, ende po e kërkojmë busullën e udhëheqjes me vizion, integritet e kompetencë këtu brenda që nuk do të frikësohej t'i diskutonte çështjet e mësipërme dhe do t'i merrte masat adekuate. Kjo do ta vazhdonte ëndrrën e këputur dhe do ta ndalte dëshpërimin, për ta kthyer atë në shpresë. Sado e vështirë të jetë, nuk duhet të ndalemi së kërkuari.